

PROJEKTI I KONKURRUESHMËRISË LOKALE DHE RAJONALE

Lista e Kontrollit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social

Përshtatja e ofertës dhe shërbimeve në destinacionin Shkup,
Kumanovë dhe rrethinë (rajoni i Bit Pazarit në Shkup) për t'u
shërbyer segmenteve të identifikuara të tregut me potencial të lart

Hoteli Arka, Shkup

1. PREZANTIMI I PROJEKTIT

Projekti i Konkurrueshmërisë Lokale dhe Rajonale (PKLR) është një veprimtari investimi katërvjeçare, e mbështetur nga Bashkimi Evropian, me anë të shfrytëzimit të mjeteve financiare nga IPA II, të përcaktuara për konkurrueshmëri dhe inovacione në Maqedoni. PKLR do të menaxhohet nga *Hybrid Trust Fund* dhe përbëhet nga katër komponente, dhe do të zbatohet nga Banka Botërore dhe Qeveria e Maqedonisë. Projekti do të sigurojë investim financues, së bashku me ndërtimin e kapaciteteve, me qëllim mbështetja e zhvillimit të sektorit, investimi në prosperitetin e destinacioneve të ndryshme dhe ato konkrete. Në nivelin rajonal dhe atë lokal, Projekti do të mbështesë destinacionet e përzgjedhura turistike në vend, me anë të kombinimit të asistencës teknike për të përmirësuar menaxhimin e destinacioneve, investimit në infrastrukturë dhe investimit në bashkim dhe inovacion. Investimet do të bëhen përmes një skeme të granteve për vepruesit në turizmin rajonal, siç janë komunat, institucionet, OJQ-të dhe sektori privat.

Kjo Listë e Kontrollit të Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) është përgatitur për aktivitetet që po zbatohen nga ARKA SHPKNJP Shkup. Lista e Kontrollit të PMMS prezanton përshkrimin e projektit, detajet teknike, shtrirjen, ambientin dhe pozicionin, në bazë të të cilave më tej vlerëson rreziqet për mjedisin dhe shoqërinë.

Zbatimi i masave të zbutjes të cilat adresojnë rreziqet dhe çështjet e identifikuara, si dhe plani i monitorimit i përcaktuar me Listën e Kontrollit të PMMS është njëjtë i domosdoshëm siç është edhe respektimi i normave ligjore kombëtare mbi mjedisin dhe normave tjera, si dhe i politikave operative të Bankës Botërore.

2. PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT

Nën-projekti parashikon tre faza: përmirësimi i hapësirave ekzistuese të akomodimit, aranzhimi i ambientit të një tarrace ekzistuese dhe prokurimi i pajisjes për turizëm aktiv, dhe ai përfshin:

- Blerjen dhe ngjitjen e mbështjellëseve dhe tapicerive për muret;


- c. 200 metra katrorë të tapicerive, kompensatës ose laminatit që drejtpërsëdrejti do të vendosen në muret ekzistuese në dhomat dhe zonat publike (në parashikim, tarracë dhe në sallat)

- Blerjen dhe vendosjen e pllakave të gipsit;

- c. 100 metra katrorë të pllakave të gipsit, të vendosura për të krijuar tavan dekorativ dhe ndarje të reja të mureve në zonat publike

- Blerjen e mobiljeve dhe karpentierisë (tavolina, karrige, garnitura);

- c.130 copë të mobiljeve të reja (në zyrë, në dhomën e ngrënies, në tarracë, karrige klubi, tavolina klubi dhe tavolina zyreje, sofa, varrëse rrobash, rafta librash dhe ulëse sipas specifikimeve marangoze, për dhomat, zonat e ngrënies dhe zonat publike)



Paradhoma – Mobiljet dhe karpenteria


Përpara dhe pas

- Mënjanimi i pajisjeve ekzistuese të ndriçimit, blerja dhe zëvendësimi i tyre (llambat e tavolinës, të murit dhe të dyshemesë);
 - c.70 copë të llambave LED për vendosje në tavolina, mure dhe dysheme
- Blerjen dhe vendosjen e ndarjeve nga qelqi;
 - c.40 metra katrorë të ndarjeve nga qelqi për të bërë ndarje në dhomat, zonën e ngrënies dhe në tarracë;
- Blerjen dhe instalimin e pajisjes për efikasitet energjetik në dhomat e mysafirëve (kontrollues, termostate të mençura dhe një komandë qëndrore);



Përpara dhe pas

- Furnizimi dhe zëvendësimi i pajisjeve të dyshemesë (qilime dhe laminat) në zonën e ngrënies dhe në barin e paradhomës c.170 metra katrorë;
- Furnizimi dhe vendosja e dyshemesë së dekoruar përmbi dyshemenë ekzistuese (riaranzhimi i tarracës ekzistuese): c.100 metra katrorë;



Tarraca dhe zona e ngrënies – dyshemeja ekzistuese dhe e dekoruar

- Prokurimi i pajisjes nga çeliku i pandryshkshëm për përgatitjen e ushqimit: banaqe, nën-banaqe, tavolina për përgatitje të ushqimeve të freskëta dhe tavolina ndihmëse për zonën sapo të aranzhuar (ekzistuese) të ngrënies;
- Prokurimi i pajisjes për mirëmbajtjen e ushqimit, tryezave suedeze, tryezave me ushqime të ngrohta, enëve ngrohëse, pajisjeve të ekspozimit, të zonës sapo të aranzhuar (ekzistuese) të ngrënies;
- Blerja e automjetit të pasagjerëve / furgon (EURO 6);
- Blerja e pajisjes së sportit
 - 8 biçikleta, 2 kaika dhe ulëse, jelekë shpëtimi, dhe helmetë;
- Prokurimi i makinave për larje dhe për tharje rrobash (nga një);
- Furnizimi dhe instalimi i ekraneve digjitale;
 - 5 ekrane LCD, të instaluara në zonat e brendshme dhe ato publike të hotelit

Nën-projekti nuk përfshin rritje në lartësi dhe / ose zgjerim, por është menduar për t'i ngritur dhe për t'i përshtatur hapësirat ekzistuese në vend, me qëllim përmirësimi i shërbimit.

Sipërfaqja ku do të zbatohet projekti është në kuadër të godinës së Hotelit Arka, që ndodhet në rrugën e Bit Pazarit, nr. 90/2 në Shkup, Komuna e Çairit. Godina ndodhet në parcelën kadastrale 8998/3, në komunën kadastrale Qendër 1. Ajo është regjistruar me numrin e regjistrimit të pronës 45815, në komunën kadastrale Qendër 1 dhe është në pronësi të investitorit - ARKA SHPKNJP Shkup.

Sipas dokumentacionit të planifikimit hapësinor dhe urbanistik, toka dhe godina janë përcaktuar për synimin në vijim: hotel. Projekti nuk parashikon kthimin ose devijimin nga kjo.

3. KATEGORIA MJEDISORE

3.1 Politikat e garancës të Bankës Botërore/Kategorizimi

PKLR është mbështetur me një grant të Bashkimit Evropian dhe po zbatohet bashkërisht nga Kabineti i Zëvendës Kryeministrit për Çështje Ekonomike, agjenci kjo e zbatimit të mjeteve financiare, si dhe nga Banka Botërore. PKLR është klasifikuar si projekt i Kategorisë B, që do të thotë se mund të pritet një shkallë të ndikimit të pafavorshëm, si rezultat i zbatimit të tij, por nuk është e konsiderueshme, e vëllimit të madh dhe e afatit të gjatë. Si rezultat i kësaj, është bërë klasifikimi OP 4.01 - Vlerësimi ekologjik. Si pasojë, KZKÇE ka zhvilluar një Kornizë të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS) për të administruar kujdesin e duhur për mjedisin me nën-projektet e mbështetura me skemën e granteve në kuadër të Komponentit 3, për të përkufizuar pranueshmërinë dhe procedurat për ekzaminimin dhe vlerësimin mjedisor. Të gjitha aktivitetet e projekteve (dhe nën-projekteve) domosdo të zbatohen duke ndjekur KMMS, politikat dhe procedurat operative të Bankës Botërore dhe normat ligjore të brendshme (ato më të rreptat do të mbizotërojnë).

Nën-projekti i propozuar klasifikohet si Kategoria B – për faktin se ndikimet e tij të ardhshme mjedisore janë më pak armiqësore sesa të nën-projekteve të Kategorisë A dhe B+, duke marrë parasysh natyrën e tyre, madhësinë dhe pozicionin, si dhe veçoritë e ndikimeve potenciale në mjedisin.

Kategoria kërkon një vlerësim mjedisor për të vlerësuar çdo ndikim në mjedisin që lidhet me nën-projektin e propozuar, për të identifikuar mundësitë e përmirësimit mjedisor të mundshëm dhe për të rekomanduar çdo masë të nevojitur për parandalimin, minimizimin dhe zbutjen e ndikimeve të pafavorshme. Shtrirja dhe formati i vlerësimit mjedisor do të ndryshojë varësisht nga nën-projekti, por në mënyrë tipike do të jetë më i ngushtë sesa shtrirja e vlerësimit të ndikimit në mjedis, zakonisht në formë të PMMS. Shtrirja e PMMS përkufizohet në Shtojcën D të PMMS. Për nën-projektet që përfshijnë përmirësime, rehabilitime ose përshtatje të godinave, do të përdoret lista e kontrollit e PMMS (shablloni është dhënë në Shtojcën F të PMMS).

Kategoria B- përfshin nën-projekte të cilat poashtu: (a) përfshijnë hua të kapitalit të punës, me të cilin bëhet blerja dhe/ose përdorimi i materialeve të rrezikshme (p.sh. benzina), ose (b) procesimi i përmirësimeve që përfshijnë blerjen e pajisjes/makinerisë që prezanton një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin ose sigurinë. Sipas ligjeve të Maqedonisë, tek llojet e nën-projekteve që biejnë nën Kategorinë B-, nuk është i domosdoshëm vlerësimi i ndikimit në mjedis.

3.2 Vlerësimi mjedisor sipas legjislacionit të brendshëm

Nën-projekti nuk i takon asnjë kategorie të Shtojcës I dhe Shtojcës II të Dekretit mbi Emërtimin e Projekteve dhe Krijimeve në bazë të të cilit krijohet nevoja për zbatimin e procedurës për vlerësimin e ndikimit në mjedis ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. / 2005, nr. 109/2009). Në pajtim me Udhëzimet mbi zbatimin e procedurës së përcaktimit të nevojës, përcaktimit të shtrirjes dhe rishikimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në Republikën e Maqedonisë për një projekt i cili nuk gjendet as në Shtojcën I e as në Shtojcën II, do të merret vendimi në lidhje me procedurën e përcaktimit të nevojës për vlerësimin e ndikimit në mjedis, se ky i fundit është i panevojshëm.

Sido që të jetë, sipas udhëzimeve të Njesisë së Zbatimit të Projektit të PKLR, në kuadër të raportit të skringut mjedisor, aplikuesi i nën-projektit ka dërguar një Njoftim për shprehjen e synimit zbatimin e një projekti, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – Zyra e Mjedisit Jetësor. Hotel Arka SHPK ka dërguar letër me Njoftimin për Synim në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe ka marrë përgjigje më datë 9.11.2018, me Mendimin se është i detyrueshëm procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe përgatitja e Elaboratit për Mbrojtje Mjedisore për realizimin e këtij nën-projekti. Përgjigja/Mendimi i pranuar nga MMPH është në shtojcë të kësaj Liste të Kontrollit të PMMS.

4. PASQYRA E NDIKIMEVE

Si rezultat i aktiviteteve të parashikuara të nën-projektit për rinovimin/përshtatjen e Hotelit Arka për t'u shërbyer segmenteve të identifikuar të tregut me potencial të lart, janë identifikuar ndikimet e mëposhtme:

1. Rreziqet dhe ndikimet e mundshme negative për sigurinë dhe shëndetin e popullsisë, shoferëve dhe punëtorëve (ndikimet lokale të kufizuara në sipërfaqen e rinovimit të Hotelit Arka, në afat të shkurtër, të pranishme vetëm në fazën e zbatimit), për arsye të:

- Mungesës së masave të sigurimit dhe sigurisë gjatë punimeve të rinovimit/përshtatjes,
- Lëndimeve të paraqitura në ose afër sipërfaqes së punimeve (p.sh. për shkak të mungesës së veshjeve ose pajisjes mbrojtëse, ose për shkak të mangësive tjera të sigurisë),
- Mospërputhjes me standardet e sigurisë dhe procedurave të punës,
- Menaxhimit joadekuat të trafikut dhe sigurisë së këmbësorëve.

2. Rritja e mundshme e rreziqeve për sigurinë mjedisore dhe profesioniste dhe rreziqeve për shëndetin e qytetarëve dhe pasagjerëve për shkak të mirëmbajtjes së papërshtatshme ose për shkak të mirëmbajtjes së rregullt të automjetit të pasagjerëve (EURO 6) në fazën operative.

3. Ndikimi i mundshëm në cilësinë e ajrit dhe emetimet në ajër nga makinat që transportojnë materiale dhe pajisje në sipërfaqen e nën-projektit dhe që transportojnë mbeturina jashtë zonës (ndikimi lokal, i kufizuar në sipërfaqen e rinovimit/përshtatjes, që shfaqet vetëm në fazën e zbatimit), për shkak të:

- lëshimit të pluhurit nga transportimi i materialeve, materialeve për menaxhimin dhe punët e ndërtimitarisë, gazrat që shkarkohen nga makinat dhe komunikacioni, si dhe që shkaktojnë ndryshime në qarkullimin ekzistues të trafikut përreth, për arsye se sipërfaqja e rinovimit gjendet afër njërës nga bulevardet më frekuentuese të Qytetit të Shkupit.

4. Shqetësimet e mundshme nga vibracionet, shkarkimet dhe zhurma, si rezultat i automjeteve transportuese që qarkullojnë nëpër qytet drejt sipërfaqes së rinovimit (ndikimi lokal i kufizuar në sipërfaqen e rinovimit të Hotelit Arka i pranueshëm vetëm në fazën e zbatimit).

5. Menaxhimi joadekuat i mbeturinave dhe grumbullimi dhe transportimi jo me kohë i mbeturinave. Mund të shfaqen ndikime/efekte anësore të mundshme për mjedisin jetësor dhe efekte të pafavorshme për shëndetin, si rezultat i gjenerimit dhe menaxhimit të llojeve të ndryshme të mbeturinave (mbeturinat nga ndërtimi fillestar, siç është kompensata, qilimet, pëlhurat, sfungjeri, mbetjet nga pllakat e gipsit, si dhe nga druri, metalet, qelqi, plastmasa, mobiljet, dysheqet, mbeturinat e rrezikshme, instalimet e ndriçimit, mbetjet nga ngjyrat, ngjitësit dhe ambalazhet. Mbetjet nga ambalazhet (kartoni dhe najlloni) poashtu do të krijohen. Këto ndikime janë lokale (mundësisht rajonale, në varësi nga menaxhimi dhe vendi i fundit i hedhjes/përpunimit), të kufizuara në kuadrin e sipërfaqes së rinovimit të Hotelit Arka. Në qoftë se nuk është parashikuar menaxhimi si duhet i mbeturinave në fazën operative, ekziston mundësia që ndikimet negative të jenë afatgjate, me rastisje të përsëritshme, por të kufizuara në kuadrin e menaxhimit joadekuat të mbeturinave, dhe në mbledhjen dhe transportimin jo me kohë të mbeturinave publike.

6. Ndikimet në dheun dhe ujin shkaktohen nga rrjedhja, derdhja e rastësishme, nga ndërtimtaria e papërshtatshme dhe nga menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme. Megjithatë, këto aktivitete pritet të prodhojnë mbeturina vetëm përkohësisht, në nivelin lokal, në afat të shkurtër, dhe ndikimet e pafavorshme mjedisore kufizohen vetëm brenda periudhës së rinovimit.

5. QËLLIMI I LISTËS SË KONTROLLIT TË PROJEKTIT TË MENAXHIMIT TË MJEDISIT JETËSOR, KËRKESAT E SHPALOSJES

Banka Botërore kërkon vlerësim mjedisor (VM) për projektet e propozuara për financim nga Banka Botërore, për të siguruar se ato i përmbahen dhe janë të qëndrueshëm ndaj pikëpamjes mjedisore dhe kështu do ta përmirësojnë procesin e vendimsjelljes. VM është një proces, gjerësia, thellësia dhe lloji i analizimit të të cilit varet nga natyra, shtrirja dhe ndikimet e mundshme mjedisore të projektit të propozuar. VM vlerëson rreziqet e mundshme mjedisore të projektit, si dhe ndikimet e tyre në zonën e përfshirë me projektin.

Sipas ekzaminimit të zbatuar të Aplikimit për Shprehje të Interesit (duke përfshirë këtu Pyetësin Mjedisor, nën-projekti “Përshtatja e ofertës dhe shërbimeve në destinacionin Shkup, Kumanovë dhe rrethinë (rajoni i Bit Pazarit në Shkup), për t’u shërbyer segmenteve të identifikuar të tregut me potencial të lart”, u kategorizua si B-. Nën-projektet po klasifikohen me Kategorinë B- - ndikimet potenciale mbi mjedisin jetësor janë më pak të dëmshme sesa të nën-projekteve brenda kategorive A dhe B+, duke ditur natyrën, madhësinë dhe pozicionin e tyre, si dhe veçoritë e ndikimeve mjedisore potenciale.

Shtrirja e vlerësimit mjedisor të nën-projekteve mund të jetë e ndryshme për nën-projektet e ndryshme, por zakonisht është më e vogël sesa shtrirja e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, më së shpeshi në formën e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS). Për nën-projektet që parashikojnë përmirësime të rëndomta, rinovime ose përshtatje të godinave, përdoret Lista e Kontrollit e PMMS. Forma e Listës së Kontrollit të PMMS përkufizohet me Kuadrin Social të Projektit të Konkurrueshmërisë Lokale dhe Rajonale.

Lista e Kontrollit e PMMS aplikohet për rehabilitime të vogla ose për ndërtim të godinave të vogla. Ajo ofron “praktikë të mirë pragmatike” dhe është disenjuar të jetë miqësore për përdorim dhe t’u përmbahet kushteve të garancisë së Bankës Botërore. Format i llojit të listës së kontrollit orvatet të përfshijë qasje tipike të zbutjes për kontrata të zakonshme të punës ndërtimore me ndikime të lokalizuara.

Lista e Kontrollit ka një paragraf të hyrjes (pjesën hyrëse, në të cilën përshkruhet projekti, pjesa ku përkufizohet kategoria mjedisore, ndikimet e identifikuar dhe sqarohet koncepti i listës së kontrollit të PMMS) dhe tre pjesë kryesore:

- **Pjesa 1** formon pjesën përshkruese (“pasaportën e sipërfaqes”) e cila përshkruan specifikat e projektit, në kuptimin e pozicionit fizik, aspektet institucionale dhe legjislative, përshkrimin e projektit, duke përfshirë këtu dhe nevojën për një program të ndërtimit të kapaciteteve dhe përshkrimin e procesit të konsultimit publik.
- **Pjesa 2** përfshin skringun mjedisor dhe social me një format të thjeshtë Po/Jo, i vijuar nga masat e zbutjes për çdo aktivitet të numëruar.
- **Pjesa 3** është një plan monitorimi i aktiviteteve gjatë ndërtimit dhe zbatimit të projektit. E mban formatin e njëjtë i cili kërkohet për PMMS standarde të Bankës Botërore. Synimi i kësaj liste të kontrollit është që Pjesa 2 dhe Pjesa 3 të inkuadrohen si dokumente aplikimi për kontraktuesit.

Procedura e publikimit të Listës së Kontrollit të PMMS është si vijon: Lista e Kontrollit e PMMS në gjuhën maqedone, shqipe dhe anglishte duhet të publikohet në ueb faqen e PKLR dhe të pranuesit, si dhe në ueb faqet e komunës së prekur, dhe duhet të jetë në dispozicionin e publikut për të paktën 14 ditë. Duhet të printohet dhe të vihet në dispozicion në hapësirat e

PKLR dhe në komunat relevante dhe / ose në qendrat e rajoneve planore. Kur publikohet, thirrja për vërejtje rreth dokumenteve duhet të lëshohet së bashku me adresën e disponueshme elektronike dhe postale, për dërgimin e vërejtjeve. Regjistri i dëgjimit publik (komentet dhe pyetjet e mbledhura) përmban informacionet elementare në lidhje me vendin, listën e personave të pranishëm dhe përmbledhjen e vërejtjeve të pranuara, dhe duhet të përfshihet në versionin përfundimtar të dokumentit të publikuar.

6. PËRDORIMI I LISTËS SË KONTROLLIT TË PMMS

Lista e Kontrollit e PMMS paraqet një dokument i cili është përgatitur dhe është pronësi e Hotelit Arka SHPKNJP. Procesi i disenjimit të nën-projektit “Përshtatja e ofertës dhe shërbimeve në destinacionin Shkup, Kumanovë dhe rrethinë (rajoni i Bit Pazarit në Shkup), është parashikuar që t’u shërbejë segmenteve të identifikuara të tregut me potencial të lart”, do të zbatohet në tre faza:

1. *Faza e identifikimit të përgjithshëm dhe e themelimit*, brenda së cilës përzgjedhet lënda e rinovimeve dhe përshtatjes dhe elaborohet një program i përafërt për tipologjitë e punës potenciale. Në këtë fazë hartohen Pjesët 1, 2 dhe 3 të Listës së Kontrollit të PMMS. Pjesa 2 e Listës së Kontrollit të PMMS mund të përdoret për të përzgjedhur aktivitete tipike nga “menyja” dhe të lidhen ato me çështjet mjedisore dhe masat e zbutjes. Pastaj mbahen konsultimet publike, dhe finalizohet PMMS.
2. *Faza e planifikimit të hollësishëm dhe paraqitjes së ofertës*, duke përfshirë specifikimet dhe parallogaritjet e punimeve ndërtimore, pajisjeve, marketingut dhe të shërbimeve tjera në lidhje me nën-projektin. Të gjitha pjesët e prezantuara në mënyre tabelare të PMMS (Pjesa 1, 2 dhe 3) do të bashkëngjiten si pjesë përbërëse e dokumentacionit të ofertës dhe kontratat e punës dhe kontrata e mbikëqyrjes, në analogji me të gjitha shprehjet teknike dhe komerciale, duhet të firmosen nga palët kontraktuese.
3. *Gjatë fazës së kryerjes së punimeve* kriteret e përshtatjes mjedisore (me Listën e Kontrollit të PMMS dhe rregullat e shëndetësisë dhe sigurisë) dhe kriteret tjera kualitative zbatohen në sipërfaqen e dhënë dhe aplikimi kontrollohet/mbikëqyret nga mbikëqyrësi i sipërfaqes, që do të thotë inxhinieri mbikëqyrës ose mbikëqyrësi i projektit, të emërtuar për mbikëqyrjen e zbatimit të Listës së Kontrollit të PMMS. Masat e zbutjes në Pjesën 2 dhe plani i monitorimit në Pjesën 3 paraqesin bazën e verifikimit të përshtatjes së Kontraktuesit me dispozitat e kërkuara mjedisore.

Aplikimi praktik i Listës së Kontrollit të PMMS do të nënkuptojë pasjen dhe dokumentimin e të gjitha veçorive që janë relevante për sipërfaqen. Në pjesën e dytë, aktivitetet që do të zbatohen, do të kontrollohen sipas llojit të parashikuar të aktivitetit dhe në pjesën e tretë do të identifikohen dhe aplikohen parametrat e monitorimit (Pjesa 3), sipas aktiviteteve të prezantuara në Pjesën 2.

E tërë Lista e Kontrollit e PMMS, e plotësuar në tabelë (Pjesa 1, 2 dhe 3) për çdo lloj të punës, duhet të bashkëngjitet si pjesë përbërëse e kontratave të punës dhe si analoge me të gjitha kushtet teknike dhe komerciale, të cilat duhet të firmosen nga palët kontraktuese.

7. MASAT E ZBUTJES

Masat për shmangien dhe reduktimin/zbutjen e ndikimeve të identifikuar në mjedisin jetësor, në punëtorët dhe komunitetet, dhe aspektet sociale të nën-projektit që do të aplikohen brenda nën-projektit janë, por nuk janë të kufizuara në, si vijon më poshtë:

Shënimi adekuat i sipërfaqes së renovimit, shënimi i sipërfaqes adekuate për magazinim të përkohshëm të materialit ndërtimor në sipërfaqen e ndërtimit, sigurimi i shiriteve të paralajmërimit, gardheve dhe shënimeve, duke ndaluar kështu hyrjen e personave të papunësuar brenda shiriteve të paralajmërimit, me aplikimin e masave të sigurisë për qytetarët, makinat duhet të drejtohen vetëm nga stafi me përvojë dhe i trajnuar, me praninë e përhershme të aparateve zjarrfikëse, në rast të zjarrit ose dëmit tjetër, duke mbajtur pajisje dhe veshje mbrojtëse gjatë gjithë kohës, skele fikse dhe masa tjera për shëndetin dhe sigurinë, lëngjet e ndezshme mund të vendosen dhe të ruhen ekskluzivisht në enë të disenjuara për këtë qëllim.

Gjithë punëtorët patjetër duhet qenë të vetëdijshëm për rreziqet nga zjarri dhe masat zjarrfikëse dhe patjetër duhet qenë të trajnuar për të manovruar me aparatet zjarrfikëse, hidrantët dhe aparatet tjera që përdoren për fikjen e zjarreve, e të cilat duhet qenë në funksion.

Niveli i zhurmës nuk guxon të tejkalojë 55dB gjatë ditës dhe 45dB gjatë natës, ndërsa punët e ndërtimitarisë nuk do të zbatohen gjatë natës (orët e rinovimit 7.00 deri 19.00).

Identifikimi, klasifikimi dhe magazinimi ndaras i përkohshëm (në shporta/kontainerë mbeturinash, të shënuara qartë në një zonë të parapërcaktuar në faqen e ndërtimit në numër të mjaftueshëm) të llojeve të ndryshme të mbeturinave, të cilat mund të gjenerohen nga rinovimi dhe trajtimi i duhur i mbeturinave. Mbeturinat mund të transportohen në deponi/të procesohen vetëm nga kompani të licencuara.

Vendosja e regjimit të posaçëm të trafikut për automjetet e Kontraktuesit gjatë periudhës së rinovimit, me sinjalizimin përkatës.

Firmosja e kontratës me kompaninë e shërbimit për mirëmbajtje të rregullt, zëvendësimi i pjesëve rezervë, ndërrimet parandaluese të lubrikantëve, mirëmbajtja përkatëse (shkarkimi i gazrave dhe sigurisë, gjegjësisht, frenat, gomat, etj.) si një nga funksionet më të rëndësishme të sigurisë, etj., larja me rregull e automjeteve dhe mbajtja e vendparkimit në gjendje të pastër, zëvendësimi i ndaluar i vajit të motorit në vendparkim, për të shmangur vajin dhe ndotjen e ujërave dhe dheut, zbatimi i testit të rregullt vjetor të aprovimit gjatë regjistrimit vjetor të automjeteve.

Masat e sigurisë të përshkruara në këtë seksion janë të përgjithshme, masat e hollësishme të detyrueshme të zbutjes janë dhënë në Tabelën e Listës së Kontrollit për Masat e Zbutjes (Pjesa 3).

8. PROCEDURAT E MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT DHE NDARJA E PËRGJEGJËSIVE

Për monitorimin e zbatimit të Listës së Kontrollit të PMMS të Kontraktuesit, mbikëqyrësi i faqes së ndërtimit, ose personi përgjegjës i emërtuar nga Përfituesi (në rastin e punimeve që nuk kërkojnë angazhimin e një inxhinieri mbikëqyrës; në tekstin e mëtejshëm: mbikëqyrësi i faqes së ndërtimit) do të punojnë me Pjesën 2 dhe 3 të Listës së Kontrollit të PMMS,

gjegjësisht, planin e monitorimit. Pjesa 2 dhe 3 zhvillohet në detajet e domosdoshme, me përkufizimin e masave të qarta të zbutjes dhe monitorimit, që mund të përfshihen në kontratat e punës, gjë kjo e cila reflekton statusin e praktikës mjedisore në faqen e punimeve dhe e cila mund të vëzhgohet/matet/kuantifikohet/verifikohet nga mbikëqyrësi gjatë punimeve.

Pjesa 3 praktikisht reflekton kriteret kryesore të monitorimit mbi masat e dhëna të zbutjes, që mund të kontrollohet gjatë dhe pas punimeve, për të siguruar konformitetet dhe në fund, për shpërblimin (hakun) e Kontraktuesit.

Masat e tilla të zbutjes përfshijnë, por nuk kufizohen në, përdorimin e Pajisjes Mbrojtëse Personale (PMP) nga punëtorët në sipërfaqe, gjenerimin e pluhurit dhe parandalimin, sasinë e ujit të shfrytëzuar dhe të shkarkuar në faqen e ndërtimit, trajtimin e ujërave të zeza, prezencën e hapësirave përkatëse sanitare për punëtorët, mbledhjen e mbeturinave të llojeve të ndryshme (prej druri, metali, plastike, mbeturina të rrezikshme, p.sh. mbetje të ngjitësve dhe ngjyrës dhe nga paketime, poçe drite), sasinë e mbeturinave, organizimi si duhet i shtegjeve të shkarkimit dhe sipërfaqet, ose rishfrytëzimi dhe reciklimi aty ku është e mundur. Veç Pjesës 3, mbikëqyrësi i faqes së ndërtimit duhet kontrolluar nëse Kontraktuesi është në harmoni me masat e zbutjes të Pjesës 2. Raportimi mbi zbatimin e praktikave duhet të përshkruhet në raportin e rregullt përpara Njesisë së Zbatimit të Projektit.

Një raport i pranueshëm i monitorimit nga Kontraktuesi ose mbikëqyrësi i faqes së ndërtimit do të ishte kushti për pagimin e plotë të shpërblimit të dakorduar me kontratë, njëjtë si kriteret teknike ose sondazhet e cilësisë. Raportimi mbi zbatimin e Listës së Kontrollit të PMMS do të bëhet në çdo tre muaj. Për të siguruar shkallën e fuqisë së performancës mjedisore të Kontraktuesit, do të futet një klauzulë përkatëse në kontratat e punës, ku do të specifikohen ndëshkimet në rast të mospërputhjes së dispozitave kontraktuese mjedisore, p.sh. në formën e mbajtjes së një proporcioni harmonizuar të pagesave deri në aplikimin e masave korrektuese dhe nën-projektit, ku madhësia e tyre varet nga ashpërsia e shkeljes së kontratës. Për rastet ekstreme, përfundimi i kontratës do të bëhet me marrëveshje.

Zbatimi i masave të përcaktuara me Listën e Kontrollit të PMMS do të monitorohet nga mbikëqyrësi/inxhinieri mbikëqyrës, Qyteti i Shkupit / Inspektori Mjedisor dhe Komunal, si dhe nga eksperti i mjedisit në kuadrin e Njesisë së Zbatimit të Projektit.

Zbatimi i masave do të respektohet përpara fillimit të punimeve, gjatë rinovimit dhe pas përfundimit të tij.

Aplikuesi(t) do të detyrohet(n) që rregullisht të dërgojë(në) raporte tremujore mbi zbatimin dhe monitorimin e masave mjedisore të zbutjes (p.sh. në formë të pasqyrës tabelare (tabelat e planit të zbutjes dhe planit të monitorimit), me një kolonë plotësuese me të cilën u jepet statusi masave, vëzhgimeve dhe komenteve, dhe monitorimi i masës (e zbatuar/jo e zbatuar, rezultatet, vëzhgimet, komentet, shqetësimet, kur, etj.).

Pjesa 1: Çështjet institucionale dhe administrative	
Vendi	Republika e Maqedonisë
Titulli i nën-projektit	Përshtatja e ofertës dhe shërbimeve në destinacionin Shkup, Kumanovë dhe rrethinë (rajoni i Bit Pazarit në Shkup) për t'u shërbyer segmenteve të identifikuara të tregut me potencial të lart
Shtirja e nën-projektit dhe aktivitetet e posaçme	Menaxhimi dhe koordinimi i nën-projektit; Përmirësimi i hapësirave të akomodimit; Aranzhimi i tarracës ekzistuese; Prokurimi i pajisjes për turizëm aktiv.
Aranzhimet institucionale (Emri dhe kontaktet)	Menaxhmenti i Projektit*
	<u>Investitori:</u> ARKA SHPKNJP Shkup Rr. E Bit Pazarit, Nr. 90/2 1000 Shkup
	<u>Koordinatori i nën-projektit:</u> Sasho Xhikovski 070 345 700 sdzikovski@hotelarka.mk
Aranzhimet e zbatimit (Emri dhe kontaktet)	Mbikëqyrja**
	Do të shënohet në një fazë të mëtejshme, pas përzgjedhjes.
Përshkrimi i faqes së ndërtimit	
Emri i faqes së ndërtimit	Rruga e Bit Pazarit, Nr. 90
Përshkruani vendndodhjen e faqes së ndërtimit, Shtojca 1: Informacionet mbi faqen e ndërtimit (numrat nga faqja e ndërtimit) <input checked="" type="checkbox"/> Po ose <input type="checkbox"/> Jo	Hoteli Arka gjendet në Rr. E Bit Pazarit, Nr. 90/2, në Komunën e Çairit të Shkupit. Hoteli është i aksesueshëm me automjetet përmes një pasazhi nga Bulevardi Kërste Misirkov dhe përmes rrugës së këmbësorëve E Bit Pazarit. Hoteli Arka është regjistruar në mënyrë përkatëse në Planin e Detajuar Urbanistik: Mavrovka, Moduli Urban: 3, Parcela 3.30 dhe gjendet jashtë zonës mbrojtëse të Bit Pazarit të Shkupit. Godina gjendet në parcelën kadastrale 8998/3, komunën kadastrale Qendër 1, dhe mban Vërtetimin e Fletë-pronës nr. 45815, komuna kadastrale Qendër 1.
Kush posedon tokën?	ARKA SHPKNJP Shkup
Përshkrimi gjeografik	Vendi: Republika e Maqedonisë Qyteti: Shkup Komuna: Çair Rajoni: Mavrovka Koordinatat: 42°00'05.8"N 21°26'19.4"E
Legjislacioni	
